

## **DRAFT/RREGULLORE**

### **PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E VENDOSJES SË EMËRTESAVE TË RRUGËVE, SHESHEVE, TERRITOREVE, INSTITUCIONEVE DHE OBJEKTEVE NË JURIDIKSIONIN E BASHKISË SHKODËR**

#### **Neni 1**

##### **Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligjit nr.9270/2004 “Për sistemin e adresave” i ndryshuar; ligjit nr. 139 /2015 “Per Vetqeverisjen Vendore”; Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër”, miratuar me vendimin e KB Nr. 60, datë 28. 12. 2020.

#### **Neni 2**

##### **Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen e kritereve dhe procedurën që duhet ndjekur për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridikcionin e Bashkisë Shkodër.

#### **Neni 3**

##### **Përkufizimet**

“Emertesa” është emri i një rruge, sheshi, territori, institucioni, objekti sipas një studimi shkencor të emrave të një vendi duke konsideruar origjinën dhe kuptimin, shqiptimin dhe përdorimin e tyre me studim historiko-shkencor.

“Bulevardi”, “rruga”, “rrugica”, “sheshi” dhe “parku” janë pjesë të territorit publik, që shërbejnë si referencë për pëershkrimin e vendndodhjes së saktë dhe unike të një ndërtese, apartamenti dhe të një trualli të lirë brenda së njëjtës njësi të vetëqeverisjes vendore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 4**

##### **Parimet e përgjithshme dhe mbrojtja e emertesave historike**

Bashkia e Shkodres mbron emertesat historike të territorit të saj, duke favorizuar emertesat të regjistrave historikë të rrugeve dhe atyre të formuara në traditën zakonore.

Emërtimi i rrugëve, shesheve, institucioneve, objekteve të reja dëshmon për evoluimin e vendit, të lidhur me fakte, personazhe dhe ngjarje shoqërore, kulturore e politike në historinë e qytetit, kombëtare ose ndërkombëtare.

### Neni 5

#### E drejta e propozimit

1. Propozimi për emërtesa rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridikcionin e Bashkisë Shkodër. mund të bëhet nga :
  - a) çdo anëtar i Këshillit Bashkiak.
  - b) Kryetari i Bashkisë.
  - c) Institucion shtetërore
  - d) Komunitete/organizata/biznese
  - e) Jo më oak se një përqind e banorëve me të drejtë vote Brenda territorit të Bashkisë

### Neni 6

#### Kriteret për emërtimin e adresës

1. Çdo bulevard, rrugë, rrugicë, shesh, park ose institucion ka vetëm një emër të caktuar.
2. Nuk lejohet që në të njëjtin qytet ose fshat të Bashkisë Shkodër të ketë më shumë se një bulevard, rrugë, rrugicë, shesh ose park me të njëjtin emër.
3. Bulevardet, rrugët, rrugicat, sheshet ose parqet mbajnë emrin e caktuar në të gjithë gjatësinë e tyre.
4. Në rrugën me një dalje vendoset emër i veçantë, kur në të ka mbi 10 banesa ose kur në planin rregullues parashikohet dalje në një rrugë tjeter. Kërkesa, sipas kësaj pike, zbatohet edhe në fshatra.
5. Për rrugicat me një dalje ose me më pak se 10 banesa përdoret emri i rrugës ku ato kanë dalje.
6. Emërtimi i bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve ose parqeve dhe institucioneve, aty ku është e mundur merr në konsideratë emërtimet e vjetra ashtu si komuniteti i ka

quajtur dhe orientohet për periudha të gjata kohore, duke marrë në konsideratë rëndësinë historike apo gjeografike të zonës, apo që lidhet me një ngjarje apo aktivitet të shënuar historik.

7. Lejohet emërtimi i rrugëve për persona, vetëm pas vdekjes, në këtë rast propozimi shqyrtohet pasi tëjeta marrë dhe miratimi nga ana e familjarëve të të ndjerit.

8. emri i bulevardit/rrugës/rrugicës/sheshit ose parkut ku ka daljen ndërtesa dhe përcaktohet vetëm me njërin nga elementet e mësipërme. Emri formohet nga shkronja të alfabetit shqip dhe numra arabë, por jo vetëm me numra;

9. Nuk lejohen emërtime rrugësh që promovojnë marketing, kompani, produkt apo shërbim të caktuar.

10. Nuk lejohet emërtimi I rrugëve, sheesheve, bulervardeve, rrugicave, parqeve, institucioneve per persona që kanë qenë bashkëpuntorë të ish-sigurimit të shtetit.

11. Në çdo rast, ndryshimi i emrit të zonave të qarkullimit duhet të kufizohet në raste të jashtëzakonshme dhe të motivuara siç duhet, për të mos rrezikuar performancën e mirë të shërbime publike dhe shqetësim për popullsinë rezidente dhe në përpjekje me dispozitat ligjore.

Në rast të ndryshimit të emrit të zonës së qarkullimit, ai duhet tregohet në tabele edhe emri i mëparshëm.

12. Konsideratë duhet t'i u jepet emrave të një individi, pas një kontributi të shqar në një fushë të caktuar të artit,kulturës,edukimit,historisë, shkencës , çështjes kombëtare etj

13. Emri i propozuar, mundësishet duhet të përmbarë dy fjalë. (p.sh Rruga Gjergj Fishta) propozimi i emrave që përbajnë 3-4 fjalë nuk rekomandohet.

14. Emrat e përkthyer, apo të personaliteteve të jashtme të cilët kanë dhënë kontribut për Shkodrën duhet të janë të shkruar në gjuhën shqipe.

15. Një emër rekomandohet mos ti kaloi 30 germa, port e shenohet me shkurtesa.

16. Nuk pranohet emërtimi i rrugëve të cilat janë afër dhe mbajnë emërtime të ngjashme në drejtshkrim apo shqiptim (p.sh Alban dhe Arban) apo me fonetikë të dyfishtë.

13). Emëritimet e propozuara duhet të jenë të veçanta, të shmanget konfuzioni ,diskriminimi, të mos jenë përcmues në aspektin racor, gjinor , ngjyrës, besimit apo përcaktimit politik .

14). Ndalojen emëritimet në raste kur përdoren me iniciale apo shkurtesa, emëritimet në gjuhët e huaja, emërtime të familjes, emërtime përshkruese, në rastet kur cënon lexueshmërinë e emërtesës.

#### Neni 7

#### **Procedura e propozimit dhe dokumentacioni shoqërues**

1. Propozimi për emërtime dhe riemërtime duhet të bëhet në formë të kërkesës zyrtare nga subjektet që kanë të drejtën e propozimit sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje duke ju drejtuar Këshillit Bashkiak Shkodër.

2. Kërkesa duhet të përmbajë vullnetin e komunitetit të caktuar të shprehur nëpërmes nënshkrimeve.

3.Kërkesa duhet të vijë e arsyetuar dhe të përmbajë biografinë apo historikun varësisht për çka bëhet fjalë, për individ apo ngjarje.

4. Këshilli bashkiak krijon komisionin ad hoc për emertesat, me funksione konsultative për lëndën e emertesave së rrugeve, shesheve, institucioneve, parqeve, objekteve, rrugicave.

#### Neni 8

#### **Perbërja, Funksionimi dhe kohëzgjatja e komisionit ad hoc**

1.Komisioni keshillimor për emertesat është i përbërë nga 5 anëtarë:

- Kryetar I këshillit bashkiak ose një këshilltar I deleguar;
- një përfaqësues i organit ekzekutiv të Bashkisë;
- 3 ekspertë të jashtëm me ekspertizë të njohur.

2.Emërimi bëhet me vendim të Këshillit Bashkiak dhe komisioni qëndron në detyrë deri në përfundim të mandatit I vjecar.

3.Anëtarët e jashtëm zgjidhen për kompetencë profesionale, për role institucionale ose përreputacion të qartë, mes qytetarëve ekspertë në disciplina të tilla si historia, traditat dhe kultura lokale, arkitektura, topografia lokale, arkivat ose tema të tjera që lidhen me emertesat.

### Neni 9

#### **Veprimitaria e Komisionit ad hoc**

- 1.Komisioni keshillimor për emertesat thirret sa herë që është e nevojshme nga kryetari, i cili kujdeset për rendin e ditës. Seancat janë të vlefshme kur mblidhet shumica absolute e anëtarëve dhe propozimet konsiderohen të miratuara nëse e marrin atë shumica absolute të të pranishmëve;.
- 2.Mbledhjet e Komisionit përpilohen nga Sekretari, raport i cili u dërgohet anëtarëve brenda 20 ditëve. Operacioni
- 3.Në rast të mungesës ose pengimit të Kryetarit, mbledhja drejtuhet nga anëtari më i madh të Komisionit.

### Neni 10

#### **Miratimi i propozimit**

1. Këshilli bashkiak është autoriteti përgjegjës për miratimin ose jo të propozimit për emërtesat e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve, dhe objekteve në juridikcionin e bBshkisë Shkodër.
2. Votimi i propozimit bëhet çdo herë i fshehtë, sipas përcaktimeve të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

### Neni 11

#### **Ceremonia e dhënies së titullit dhe emërtesës**

1. Ceremonia e dhënies së emërtesës organizohet në bashkëpunim nga autoriteti përgjegjës për miratimin, dhe ai propozues, brenda 30 ditëve nga miratimi i tij.
2. Ceremonia bëhet publike.
3. Si rregull organizimi i ceremonive duhet të jetë e lidhur me përvjetorë apo ngjarje të rëndësishme historike, kulturore, kombëtare, etj.

## **Neni 12**

### **Hyrja në fuqi**

- Kjo rregullore hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Anëtarët e Komisionit ad hoc për titujt e nderit dhe emertesave:

1. Uarda Gjekaj
2. Florian Bianku
3. Plarent Anamali
4. Muhamet Shkaju
5. Marina Duhani
6. Gloria Shllaku
7. Amina Lici